



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr.11

Prishtinë, më 17.04.2015 ora: 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

Procesverbal

i mbledhjes së komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Xhevahire Izmaqi, Alma Lama dhe Zafir Berisha.

Mungoi: Shqipe Pantin, Pal Lekaj dhe Jelena Bontic.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Në mbledhje morën pjesë: nënkryetari i KPM-së dhe shefja ekzekutive e KPM-së dhe përfaqësuesit e Federatës Sindikale të RTK-së.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2014;**
- 4. Takimi i Komisionit me përfaqësuesit e Federatës Sindikale të RTK-së;**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës;

Alma Lama- Ligji duhet të ndryshohet por propozoi që të tejkalohej praktika e bartjes së ditëve të pushimit të festave zyrtare. Numri i madh i festave shtetërore po e bëjnë Kosovën një shtet dembel, por për këto propozime do të hartoj amandamente që të mos bëhet shtyrja e ditëve të festave zyrtare në ditë vijuese, pune, por këto do të bëjë në fazën e shqyrtimit të dytë të projektligjit.

Zenun Pajaziti - tha se si shtet i ri, Kosova duhet t'i trajtojë datat e shumta të festave dhe duhet t'i respektojë, por pa i shpallur ditë pushimi.

Kujtim Paçaku – propozoi që ditë feste të inkorporohet edhe dita e viktimave të Holokaustit si dhe dita e pakicave kombëtare në Kosovë.

Xhevahire Izmaku – përkrahu mendimin që të gjitha festat të festohen por që të mos jetë për secilën festë ditë pushimi.

Sadri Ferati – të gjithë kemi shqetësimin për numrin e madh të festave, por për këto duhet diskutuar në procedurën e amandamentimit të projektligjit, ndërsa sot jemi në fazën për të miratuar në parim ose jo projektligjin.

Konstatim: Komisioni unanimisht miratoi në parim projektligjin për festat zyrtare dhe nxori rekomandimin si ne vijim:

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 56 paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më dt. 17.04.2015, shqyrtoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës, dhe vendosi që Kuvendit t’ia paraqet këtë:

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet në parim Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës.
2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 56 paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional shqyrton projektligjin në parim, para leximit të parë në mbledhje plenare, dhe Kuvendit i paraqet raport me rekomandime për miratim në parim.

Komisioni, pas shqyrtimit, në parim, të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës, vlerësojë së projektligji i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2014;

Zenun Pajaziti – i njoftoi përfaqësuesit e Sekretariatit të KPM-së se komisioni do ta shtyjë shqyrtimin e raportit të KPM-së për mbledhjen e radhës në mungesë të pjesëmarrjes së anëtarëve të KPM-së.

Naile Selimaj – e njoftoi komisionin që anëtarët e bordit të KPM-së gjenden në udhëtim zyrtar, ndërsa lidhur me strategjinë për KPM, ajo tha se kanë planifikuar të takohen me komisionin parlamentar për të adresuar disa ndryshime, propozime lidhur me strategjinë me qëllim të harmonizimit të projektligjit për digjitalizim me strategjinë e digjitalizimit.

Alma Lama – kërkoi nga përfaqësuesit e KPM-së që të informohet lidhur me monitorimin e televizioneve, të cilat televizione në programet e tyre nxisin urretje ndërfetare dhe që ato janë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, janë programe të pakontrolluara dhe KPM-ja gjatë monitorimit të këtyre televizioneve nuk kishte prekur këtë çështje. Gjithashtu ajo pyeti për pagesat rreth qirasë dhe për çfarë sipërfaqe paguhet qiraja.

Xhevahire Izmaku – shprehu shqetësimet e bordit për ankesa të mediave lidhur me dënimet që bordi i ka shqiptuar ndaj disa televizioneve, ajo pyeti se a kanë përfunduar debatet meqë kishte pasur mospajtime në mes operatorëve privat rreth frekuencave – multipleks – edhe rreth adresimit të projektligjit të digjitalizimit.

Sadri Ferati – shprehu mospajtimet lidhur me procedimin e projektligjit për digjitalizimin në Komisionin parlamentar për zhvillim ekonomik, sepse është e paarsyeshme që një komision të shqyrtojë një raport vjetor të një komisioni dhe të mbikëqyrë punën e një komisioni, ndërsa komisioni tjetër të merret me shqyrtimin e projektligjit të institucionit të njëjtë.

Konstatim: Komisioni vendosi që të shtyjë shqyrtimin e Raportit të punës së KPM-së për vitin 2014, kur edhe do të jenë prezent anëtarët e KPM-së për ta prezantuar raportin në komision.

4. Takimi i Komisionit me përfaqësuesit e Federatës Sindikale të RTK-së;

Zenun Pajaziti – duke i njoftuar përfaqësuesit e federatës sindikale për arsyen, tha se meqë është hapur debat për sindikatën e RTK-se dhe që në ndërkohë ka pasur disa zhvillime në RTK, e kemi parë të arsyeshme që edhe juve si një pjesë e sindikatës së RTK-së t’ju ftojme për të dëgjuar edhe për shqetësimet e juaja brenda RTK-së. Për më tepër tani është koha që RTK, sipas ligjit duhet të raportojë para Kuvendit me raport vjetor, duke potencuar se në dy vitet e fundit Kuvendi i Kosovës nuk i ka miratuar raportet vjetore të RTK-së. Ai pastaj, ia dha fjalën kryetarit të Federatës sindikale të RTK-së,

Arsim Haliti – shqetësimet në RTK janë shqetësime edhe të sindikatës andaj në vazhden e një takimi që komisioni parlamentar ka pasur me sindikatën e RTK-së, ne si sindikatë e themeluar në vitin 2011, me arsyen e themelimit nga pakënaqësitë e punëtorëve që kanë pasur me sindikatën tjetër, kemi parë të arsyeshme që edhe ne t’ju takojmë për t’ju prezantuar shqetësimet e punëtorëve si pjesë e RTK-së. Fillimisht ata iu drejtuan komisionit që Kuvendi të orientohet në dy problemet e RTK-së, zgjidhjen e çështjes së pronës dhe çështjen e gjetjes së financimit të qëndrueshëm të RTK-së. Gjithashtu, tha se Kuvendi asnjëherë nuk ka marrë fjalën për zgjidhjen e këtyre dy problemeve.

Alma Lama – duke iu drejtuar sindikalistëve të RTK-së, ajo tha se, nuk e kishte të qartë qëllimin e takimit të sindikalistëve me komisionin pasi që ata nuk shprehen shqetësimet që atyre iu takojnë, kërkesat dhe reagimet e tyre, se a ka nepotizëm, a po shkelen të drejtat e punëtorëve, etj, porse nga diskutimet e tyre ata kishin ardhur për të takuar komisionin, si reagim që komisioni kishte takuar pjesën tjetër të sindikatës së RTK-së. Ajo kërkoi nga sindikata që ata të paraqesin shqetësimet që atyre iu takojnë në kuadër të kompetencave sindikale, por jo edhe shqetësimet për pronën dhe çështjet financiare sepse ato janë kompetencë e menaxhmentit dhe Bordit të RTK-së.

Sadri Ferati – tha se është mirë që për një çështje të kemi informacione nga kënde të ndryshme, por nga kjo që u tha sindikalistët duket që sindikalistët nuk e kanë dëgjuar debatin për RTK.

Xhevahire Izmaku – tha se, nëse raporti nuk do të del i mirë do të jetë një situatë e keqe për RTK-në dhe kjo do të dobësojë imazhin e RTK-së.

Zafir Berisha – iu tha sindikalistëve të RTK-së, se ata nuk kanë paraqitur asnjë çështje që ta mbrojnë RTK-në, nuk kanë treguar sa punëtorë i përfaqësojnë si sindikatë, se kjo sindikatë duke mos shprehur keqardhje për përjashtimin e kolegëve të tyre nga puna, sindikalistët janë përfaqësues të bordeve dhe subjekteve politike.

Ju duhet të jeni në vijë të punës dhe të mos i ndihmoni përçarjes, nuk keni sjellë asnjë raport dhe fakte për shqetësimet dhe parregullsitë në RTK.

5.Të ndryshme.

Pasi për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime, mbledhja përfundoi.

Mbledhja përfundoi në ora: 15:00.

Përgatitur nga :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Kryetari i Komisionit
Zenun Pajaziti**
